

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Për: Gjykatësin Nikola Giju
Administratore: Dr Fidelma Donlon
Parashtrues: Mbrojtësi i specializuar i Kadri Veselit
Data: 15 dhjetor 2020
Gjuha: Anglishte
Emërtimi i dosjes: Publik

Klasifikimi: Gjykatësi i
Procedurës Paraprake

**Parashtrime të Mbrojtjes së Kadri Veselit
për konferencën për ecurinë e çështjes të 17 dhjetorit 2020**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësi i Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

I. PARASHTRIMET

1. Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në përputhje me nenin 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), më 8 dhjetor 2020 lëshoi një urdhër për mbajtjen e konferencës për ecurinë e çështjen të enjten, më 17 dhjetor 2020, në orën 11:00, i cili përfshinte pikat për diskutim në atë seancë. Mbrojtjes iu kërkua të dorëzonte parashtrimet me shkrim deri të martën, 15 dhjetor 2020, në orën 16:00.

Nxjerrja e materialit

2. Mbrojtja e z. Veseli sapo ka filluar procesin e identifikimit të kategorive të materialit të nxjerrë nga ZPS-ja dhe nuk është ende në pozitë për të bërë parashtrime të informuara lidhur me përshtatshmërinë e procedurave që miratohen.

Hetimet e mbrojtjes dhe hapat e mëtejshëm

3. Bazuar në versionin më pak të redaktuar të aktakuzës, duket qartë se Mbrojtja e z. Veseli do të duhet të kryejë hetime të gjera në lidhje me secilin rast të pretenduar të zhdukjes me forcë, keqtrajtimit dhe vrasjes së qëllimshme. Sidoqoftë, Mbrojtja e z. Veseli mund të deklarojë se parashikon të caktojë një ekspert të lartë ndërkombëtar si mbikëqyrës të hetimeve të Mbrojtjes, së bashku me një ekip prej së paku gjashtë hetuesish, të cilët do të punojnë në grupe prej dy vetash. Pasi të bëhet e ditur çështja e ZPS-së, do të jetë e mundur të hartohet fusha e veprimit dhe skema e hetimeve. Mbrojtja parashikon që ky proces të mund të fillojë në fillim të vitit 2021. Duke marrë parasysh përvojat e mëparshme dhe numrin e incidenteve dhe dëshmitarëve mbi të cilët mbështetet

ZPS-ja, Mbrojtja parashikon se do t'i nevojiten së paku 18 muaj, llogaritur nga fillimi i vitit 2021, për të qenë në gjendje të përgatitet dhe të jetë e gatshme për gjykim.

Mundësitë hetimore unike (Rregulla 99(1))

4. Është shumë herët për Mbrojtjen për të qenë në pozitë të bëjë parashtrime të informuara në lidhje me një kërkesë sipas Rregullës 99(1). Mbrojtja parashikon se do t'i duhen gjashtë deri në nëntë muaj për të qenë në gjendje të vlerësojë nëse ka dëshmitarë që do të jetë e nevojshme t'i thërrasë dhe për të cilët janë të domosdoshme masat sipas Rregullës 99(1). Çështja sapo ka filluar dhe hetimet nuk kanë nisur ende. Kërkesat sipas Rregullës 99(1) mund të bëhen vetëm pasi Mbrojtja të ketë pasur mundësinë të kryejë hetime dhe të vlerësojë nevojën për dëshmitarë të caktuar. Ky është vendim që duhet të merret pas hetimeve, dhe jo para tyre.

Njoftimi për alibi apo për arsye që përjashtojnë përgjegjësi penale

5. Në një çështje që bazohet mbi pretendimin për ndërmarrje kriminale të përbashkët, fushëveprimi i një mbrojtjeje të mbështetur në alibi është shumë i kufizuar. Aktakuza më pak e redaktuar nuk jep informacion të mjaftueshëm që do t'i lejonte Mbrojtjes së z. Veseli identifikimin e periudhave kohore dhe vendndodhjeve për të cilat mund të jetë e mundshme alibia. Për sa u takon arsyeve të tjera që përjashtojnë përgjegjësi penale, Mbrojtja e z. Veseli ka bërë parashtrime në konferencën e fundit për ecurinë e çështjes dhe nuk ka asgjë tjetër për të shtuar në këtë moment.

Konferenca e tretë për ecurinë e çështjes

6. Një kërkesë e arsyetuar për lirim të përkohshëm do të parashtrohet në emër të z. Veseli përpara konferencës për ecurinë e çështjes, përkatësisht të enjten, më 17 dhjetor. Gjykatësit të Procedurës Paraprake i kërkohet të përcaktojë afatet për parashtrimin e përgjigjes nga ZPS-ja dhe të kundërpërgjigjes nga Mbrojtja, përpara konferencës së tretë për ecurinë e çështjes.

7. Mbrojtja propozon që ZPS-së t'i kërkohet të dorëzojë përgjigjen e vet deri të enjten, 31 dhjetor 2020, dhe Mbrojtja të parashtrrojë kundërpërgjigjen e vet deri të hënën, 11 janar 2021. Konferenca e tretë për ecurinë e çështjes duhet të mbahet të enjten, më 14 janar, ose rreth kësaj date, me kohë të mjaftueshme, në mënyrë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të mund të dëgjojë parashtrimet me gojë në mbështetje të kërkesës për lirim të përkohshëm.

Numri i fjalëve (në origjinal): 343

/nënshkrimi/

Ben Emerson

Mbrojtësi i specializuar i Kadri Veselit

E hënë, 9 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë.